

## Për të kryer transport jashtë norme

Duhet të plotësoni në mënyrë korrekte kërkesën **për paisjen me autorizim për mjetet dhe transportet jashtë norme**, për të qarkulluar në akset rrugore kombëtare të Republikës së Shqipërisë, bazuar në ligjin Nr. 8378, datë 22.07.1998 “Për Kodin Rrugor të Republikës së Shqipërisë” dhe akteve të tjera nënligjore në fuqi.

Shoqëria që kërkon të pajiset me Autorizim për transport jashtë norme, duhet të jetë i pajisur me Licensë për Transport të Mallrave me Mjete Jashtë Norme, e cila merret pranë DPSHTRR-së.

Gjithashtu shoqëria duhet të pajiset me një policë sigurimi për Përgjegjësitë nëse shkaktohen dëmtime në rrugë ose në pjesët e saj, gjatë kryerjes së transporteve.

Më poshtë do të gjeni rubrikat që duhet të plotësoni për këtë qëllim:

1. Për paisjen me autorizim të njëfishtë, për mjete jashtë norme dhe për transporte në kushte jo-normale, kërkuesi duhet të dërgojë pranë Autoritetit Rrugor Shqiptar, një kërkesë me shkrim ku të përcaktojë qartë :
  - a) Përshkrimi i përgjithshëm i ngarkesës dhe amballazhit të saj (sipas kërkesës së subjektit), që përfshin edhe natyrën e materialit dhe amballazhit nëse ka; Per mallin qe transportohet duhet te paraqitet edhe certifikata e mallit, ku te vertetohet tonazhi qe do te transportohet.
  - b) Skema grafike gjatësore, tërthore dhe planimtriqe që paraqet mjetin ose kompleksin e mjeteve, duke përfshirë edhe mjetet rezervë me ngarkesë, të parashikuar në pozicionin më të keq; Te gjitha skemat duhet te jene te plotesuara me te gjitha permasat, si dhe te tregohet tipi i akseve, sipas tabelës 1.3, neni 17 te Regullores ne zbatim te Kodit rrugor.
  - c) Kufiri maksimal i përmasave;
  - ç) Kufiri maksimal i masës së përgjithshme së bashku me mjetet dhe shpërndarja e ngarkesës në akse, si bosh, ashtu edhe me ngarkesë, e cila i korrespondon kufirit maksimal të masës.
  - d) Duhet të tregohen presionet e fryrjes së gomave dhe qëndra e rëndesës së ngarkesës komplekseve, i vërtetuar nga dokumenti përkatës i provës;
  - e) Kur kryhen transporte në kushte jo-normale sipas nenit 61 të Kodit Rrugor, ***kërkesës i bashkëlidhet edhe një deklaratë për brendapërshkrimin në kthesa në të gjithë itinerarin e mjetit ose kombinimit të mjeteve nga pronari ose drejtuesi i veprimtarisë së ndërmarrjes edhe në transportet në kushte jo-normale sipas nenit 62 të Kodit Rrugor, një dokument (deklaratë) i ngjashëm lëshohet edhe për qëndrueshmërinë e veprave të artit nga Studio private***;
  - f) Emrin, emrin tregëtar dhe adresën e transportuesit;
  - g) Emrin e prodhuesit dhe targën e mjetit motorik dhe mjeteve rezervë (rimorkiove/gjysmë-rimorkiove);
  - h) Përmasat maksimale të mjetit motorik (dhe mjeteve rezervë jashtë norme) në përputhje me llojin e mjetit sipas targave ( gjerësia, lartësia, gjatësia);
  - i) Përmasat maksimale të ngarkesës që transportohet ( gjerësia, lartësia, gjatësia);
  - j) Përmasat maksimale të mjetit ose kompleksit të mjeteve së bashku me ngarkesën (gjerësi, gjatësi, lartësi);
  - k) Fotokopje e Lejeve te Qarkullimit (per mjetet e huaja te perkthyer dhe noterizuara).**
    - l) Masa e cdo mjeti dhe kompleksi mjetesh pa ngarkesën (tërheqësi, mjeti rezervë);
    - m) Masa e përgjithshme, maksimale për cdo mjet, si dhe kompleks mjetesh së bashku me ngarkesën (tërheqësi, mjeti rezervë);
    - n) Numri i akseve për cdo mjet (tërheqësi, mjetet rezervë);
    - o) Largësia maksimale dhe minimale aksiale ndërmjet akseve (shpërndarja aksiale për tërheqësin, mjetet rezervë);
    - p) Akset më të ngarkuar për çdo mjet brenda kufijëve të nenit 62, të Kodit Rrugor (tërheqësi, mjetet rezervë);
    - q) Vendi i kalimit kufitar për transportuesin e huaj, si dhe data dhe periudha e kalimit;
    - r) Itinerari i qarkullimit të mjetit, ku shënohen edhe pikat e kalimit të kufirit;
    - s) Shoqërimi teknik;
    - t) Data e udhëtimit/udhëtimeve kur do të kryhet transporti dhe periudhat kohore në të cilat do të realizohen udhëtimi/udhëtimet.

- u) Të dhënat mbi mjetet (lejen e qarkullimit, librezën teknike), subjektin që do të kryejë transportin, drejtuesit e mjeteve.
2. Për çdo autorizim për mjetet dhe transportet jashtë-norme llogaritet dhe tarifa përkatëse sipas legjislacionit në fuqi të Republikës së Shqipërisë, sipas tabelës 1.1, 1.2,1.3, në mbështetje të nenit 17 të Rregullores për zbatimin e Kodit Rrugor, të Republikës së Shqipërisë (VKM Nr. 153, date 07.04.2000, si dhe ne mbështetje te nenit 18, pika 2 paisjen me police siguracioni te vecante, qe garanton demet e mundeshme qe mund te shkaktohen ne rruge, ose pjeset qe i perkasin rruges. Faleminderit për mirëkuptimin.